



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
KUÇOVË

Nr. 4331 Prot.

Kuçovë, më 31.12. 2021

V E N D I M

Nr. 84, datë 23/12 2021

“PER DISA NDRYSHIME DHE SHITESA TE VKB NR.74 DATE 24.11.2021 PER  
MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PER VITIN 2022”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij në datë \_\_\_/\_\_\_/2021, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

V E N D O S I:

1. Kreun I, pika 2/a Taksa mbi ndërtesën pjesa "Penalitet" ndryshohet si me poshtë :  
" Shkeljet e dispozitave për taksën e ndërtesës, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
2. Ne Kreun I, pika 12 "Tarifa për dhënien leje non stop " të shtohet paragrafi :  
...çdo kërkesë "Për dhënie Leje Non Stop", drejtoritë përgjegjëse të zbatojnë rigorozisht kërkesat e Urdhrit nr.99 date 10.02.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për Kufizimin e lëvizjes brenda vendit", ndryshuar me Urdhrin nr.99/2 date 29.06.2021.
3. Ngarkohet Drejtoria e te Ardhurave Vendore për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hynë ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Berat.

Ky vendim u miratua me 16 vota Pro, — vota kundër dhe — vota abstenim.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK  
MIGENA BULLARI